



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME



Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Pronën e
Paluajtshme Komunale Nr.333-16 në Zonën Kadastrale – Davidoc

Npi-01/90 datë: 12.03.2025

Bazuar në: Nenin 17 paragrafi 1, nenin 19 paragrafi 1,3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 21 paragrafi 3 dhe 6, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës; Njoftimin Publik Npi-01/62 i datës 19.02.2025; Raportin Përfundimtar Npi-01/88 të datës 12.03.2025 të Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale Zonën Kadastrale Davidoc. Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2025 unanimisht aprovoi këtë:

REKOMANDIM PËR KUVENDIN E KOMUNËS – SHTIME

I

Që të miratoi Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në Ngatrën Kadastrale Nr.P-72809023-00333-16 me sipërfaqe prej 2894 m², në Zonën Kadastrale Davidoc, vendi i quajtur “Utrinë”, evidentuar pronë e Komunës së Shtimes, Biznesit STN “BETON” SH.P.K, me numër indetifikues të biznesit Nr.810199712, Adresa, Rr. “Ibrahim Rugova” Nr.1414 Davidoc, Komuna - Shtime, me përfaqësues Shqipdon Abazi.

II

A r s y e t i m: Bazuar në Raportin Përfundimtar, Npi-01/88 të datës 12.03.2025, të Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale në Zonën Kadastrale, Davidoc, Ofertuesi më i favorshëm i ka plotësuar të gjitha kriteret nga Njoftimi Publik Npi-01/62 të datës 19.02.2025 dhe është vlerësuar me 85 pikë nga anëtarët e komisionit.

Ofertuesi më i favorshëm në ofertën e tij ka deklaruar se:

- Të investojë në shumën 190,121.50 euro, deri në vitin 2026,
- Të punësoj 10 punëtor, deri në vitin 2026,
- Veprimtaria e përfituesit është shërbyese dhe përpunuese,
- Është i gatshëm të paguaj qiranë vjetore për ari në shumën prej 18 euro.

III

Bashkëngjitur gjeni:

- Njoftimit Publik Npi-01/62 të datës 19.02.2025 të shpallur nga Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale Zonën Kadastrale Davidoc.
- Raportin Përfundimtar Npi-01/88 të datës 12.03.2025.



Kryesuesi i Komisionit
Shqiprim Hyseni